



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
**AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI**  
**AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST**  
**INFORMATION AND PRIVACY AGENCY**



Nr. A - 1085/2025

Datë: 24.09.2025

|                                                                                                                                                                               |                                       |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------|
| Republika e Kosovës<br>Republika Kosova - Republic of Kosovo<br>AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI<br>AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST<br>INFORMATION AND PRIVACY AGENCY |                                       |
| ZYRA E ARKIVIT - KANCELARIJA ARHIVA - ARCHIVE OFFICE                                                                                                                          |                                       |
| Njesia Org.<br>Org. Jedr.<br>Org. Unit                                                                                                                                        | Nr. i Prot.<br>Br. Prot.<br>Prot. No. |
| 03                                                                                                                                                                            | 1154                                  |
| Nr. i Faqeve<br>Broj Stranica<br>No. of Pages                                                                                                                                 | Data:<br>Datum<br>Date                |
| 02                                                                                                                                                                            | 24 09 2025                            |

Në mbështetje të nenit 21, 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 20 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, përkitazi me ankesën nr.1085 të parashtruar më datën 15.09.2025 të z. Leutrim Retkoceri, ndaj Komunës së Prishtinës, për mosofrimin e qasjes në dokumenteve publike, të paraqitur më 03.09.2025, Agjencia për Informim dhe Privatësi nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. **Aprovohet** si e bazuar ankesa e z. Leutrim Retkoceri ndaj Komunës së Prishtinës.
2. **Obligohet** Komuna e Prishtinës që në afat prej 7 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi, t'i ofrojë qasje të plotë ndaj dokumenteve, si në vijim:
  - 2.1. Dokumentacionin zyrtar, i cili dëshmon se Komuna e Prishtinës është aktualisht në procedurë përmbartimore nga Shërbimi i Arkitektit të Kryeqytetit;
  - 2.2. Të dhënat mbi shumën totale të mjeteve financiare që Komuna e Prishtinës i ka paguar Arkitektit të Qytetit deri më tani, të ndara sipas viteve dhe/ose kontratave, si dhe shumën e paguar me kërkesë të përmbartuesit;
  - 2.3. Listën e projekteve të hartuara nga Arkitekti i Qytetit për Komunën e Prishtinës;
  - 2.4. Listën e projekteve të hartuara nga Arkitekti, të cilat komuna i ka pranuar zyrtarisht dhe që janë në zbatim ose janë zbatuar.
3. **Obligohet** Komuna e Prishtinës që ta njoftojë me shkrim Agjencinë, pas marrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.
4. Vendimi hyn në fuqi më datën e pranimit të të njëjtit.

## Arsyetim

Në bazë të nenit 20, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Agjencia ka pranuar një ankesë nga pala z. Leutrim Retkoceri, me nr. të protokollit 1085, të datës 15.09.2025, të ushtruar ndaj Komunës së Prishtinës, për mosofrimin e qasjes në dokumentet publike, të përmendur në pikën 2 të dispozitivit të këtij vendimi.

Dokumentet e kërkuara kanë të bëjnë me shpenzimin e parasë publike, qasjen ndaj të cilave e garanton nënparagrafi 3.1 i nenit 17 të LQDP-së; pastaj me ushtrimin e funksioneve publike të zyrtarëve publikë, qasja ndaj të cilave parashihet të ofrohet sipas nënparagrafit 3.2 të nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike. Për më tepër, tërësia e informacioneve të kërkuara lidhet me veprimtarinë e përditshme të institucionit publik, qasjen ndaj të cilave, përmes publikimit me vetiniciativë, e parasheh nënparagrafi 2.4 i nenit 5 të LQDP-së.

Autoriteti mbikëqyrës, në kuadër të shqyrtimit fillestar të ankesës, më 15 shtator 2015, i ka përcjellë Komunës së Prishtinës një shkresë njoftuese, përmes të cilës, mes tjerash, i ka kërkuar arsyet e mosofrimit të qasjes ndaj informacioneve objekt kërkesë.

Institucioni publik nuk ka ofruar përgjigje ndaj AIP-së dhe as nuk ka dëshmuar t'i ketë ofruar qasje palës ankuese ndaj informacioneve të kërkuara, duke e detyruar autoritetin mbikëqyrës që të vazhdojë me procedurën e shqyrtimit, duke nxjerrë këtë vendim të karakterit detyrues.

Siç është përshkruar në arsyetimin e lartcekur dhe bazuar në nënparagrafin 4 të nenit 20 të Ligjit Nr.067/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Agjencia ka nxjerrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

#### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë padi për kundërshtim në gjykatën kompetente për çështje administrative brenda 30 (tridhjetë) ditësh, nga data në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

  
Jeton Arifi  
Drejtore  
Departamenti për Qasje  
në Dokumente Publike

Vendimi i dërgohet:

- Z. Përparim Rama, Zyrtar Përgjegjës, Komuna e Prishtinës
- Z. Leutrim Retkoceri, Ankues
- Arkivit të Agjencisë